

Nr. 273 Prot
Date 16.01.2026

PROCESVERBAL MBLEDHJE

Data: 15.01.2026

Ora: 17:00

Vendndodhja: Njesia Administrative Xhafzotaj,kati 3

Mungojne:

- Suzana Domi
- Erga Shkodra
- Arian Kokomani
- Kadri Metaliu
- Myrteza Ramilli


Sulejman Tola(Kryetar I këshillit):Përshëndetje të gjithëve! Është thirrur kjo mbledhje e këshillit me rastin e miratimit të listës emërore dhe masës së dëmit të të dëmtuarve nga përmytjet e shkaktuara nga reshjet e datës 06.01.2026. Për mbajtjen e projektvendimi, i japim fjalës drejtoreshës juridike, Albiona Mehmeti.

Albiona Mehmeti: Përshëndetje të gjithëve, atëherë nga materiali, përpara se të filloj dhe të relatoj, të lexoj materialin që kam këtu. Nga materiali i dërguar dje në adresat e email-it ka një ndryshim që është emërtimi i relacionit dhe janë shtuar dy emra nga dyzet e dy në dyzet e katër në total.

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 3, pika 23, nenit 7, pika 1, nenit 30, nenit 42, pika 1, shkronjat "b" dhe "d", të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 329, datë 16.05.2012 " Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare per mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njëzore" KREU III e ne vijim i tij , Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.414 datë 08.07.2021"Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar.

Paraqes materialin "Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë totale 15.010.285(Pesëmbëdhjetë milion e dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë për likuidimin e të dëmtuarve nga përmytjet e shkaktuara nga reshjet intensive të datës 06.01.2026-10.01.2026.

Si rezultat i reshjeve të shiut me intensitet të lartë të nisura në datën 06 Janar 2026 ,dhe më pas ka vijuar për disa ditë radhazi deri më datë 10.01.2026 ,të cilat përfshinë të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë , si rrjedhojë në disa banesa të Bashkisë Shijak ka patur prezencë të ujit në oborret e shtëpisë për shkak se banorët në shtëpitë e tyre nuk kanë patur projektin e disiplinimit të ujrave të bardha duke shkaktuar në këtë mënyrë përmytje të banesave, apo tek ato banesa të cilët vendndodhjen e tyre e kane në afërsi të bregut të Lumit Erzen.



Përmbytje janë shkaktuar në 44 (dyzetë e katër) familje të Bashkisë Shijak.

Bashkia shijak ka marrë të gjitha masat që të ndjekë brenda afateve ligjore të gjitha procedurat që dikton legjislacioni në fuqi për emergjencën civile.
Së pari janë ngritur komisionet e konstatimit të gjëndjes në familjet e dëmtuara, të cilat kanë pasqyruar faktet e konstatuara në një proces verbal konstatimi.

Dosja e konstatimit permban :

Procesverbali i konstatimit të gjëndjes;

Karte ID dhe certifikate familjare

Foto

Dokument i cili verteton lidhjen me pronesine e familjarit (Certifikate pronësie, Vertetim Legalizimi, Vertetim OSHE,UKD, Vertetim nga kryetari i fshatit)

Më pas puna ka vijuar me ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve materiale në familjet e dëmtuara si dhe përgatitjen e preventivave të dëmeve.

Preventivat janë bazuar referuar :

- Çmimet janë marrë sipas listës se DREJTORISE RAJONALE TATIMORE DURRES , si dhe cmimeve mesatare te tregut per disa artikuj te cilat nuk jane te perfshira ne listen e lartpermendur.
- Cmimet per njesi jane llogaritur me TVSH

Bazuar në preventivat e përgatitur nga komisioni i ekspertëve të Bashkisë, dëmi real në total është **15.010.285**(Pesëmbëdhjetë milion e dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë , ndërsa për cdo familje individualisht është sipas listës më poshtë shënuar:

Preventivat e dëmeve në orendi, mobilie dhe pajisje elektroshtëpiake bëhen pjesë përbërëse e dojes së konstatimit .

Spektori i emergjencave civile i Bashkisë së Shijakut ka lajmëruar paraprakisht familjarët duke minimizuar kështu dëmin dhe parandaluar në një masë të gjerë dëmtimet në orendi e pajisje eltro-shtëpiake të objekteve private ndodhura më pranë shtratit të Lumit.

Duke qenë se procedura vijon me miratimin në Këshillin bashkiak të listës emërore të të dëmtuarve dhe të masës së dëmit paraqesim për miratim Listen e lartpërmendur dhe duke qenë se Bashkia Shijak nuk ka mundësi financiare për përballimin e kësaj shtate dhe për të shpërblyer financiarisht familjarët e dëmtuar kërkojmë edhe miratimin e propozimit për ti kërkuar ndihmë financiare Këshillit të Qarkut Durrës dhe Agjencise Kombetare te Mbrojtjes Civile pranë Ministrisë së Mbrojtjes .

Marilda Tusha: (këshilltar): Cilët janë dy emrat që janë shtuar listës që na keni sjellë ?

Albiona Mehmeti (Drejtoresha Juridike): Suzana Baci dhe Sami Delallisi në bashkinë Shijak, pra në qyteti. Spektori i emergjencave civile të bashkisë Shijakut ka lajmëruar paraprakisht familjarët në momentin .

Bashkim Hoxha (këshilltar):Në relacion jeni shprehur gabim.Përmbytja vinte nga 4-rrugët-Shijak që është një rrugë nacionale.Ne duhet vtë na japi dëmshpëblim Bashkia e Durrësit.Kanalet tona janë pastruar.Tek listaqë n akeni dhënë kompensohet ai që është në



breg dhe nuk kompensohet ai që është në gropë. Nuk e di çfarë pune ka bërë komisioni. Një përfaqësues I komisionit të dali dhe të thotë I kemi parë të gjitha shtëpitë.

Albiona Mehmeti (Drejtoresha Juridike): Atëherë, vetëm për të sqaruar një pikë. Anëtarët e komisionit kanë shkuar në çdo shtëpi për të cilët është paraqitur një kërkesë apo një ankesë dhe kanë vlerësuar dëmet. Janë katër grupe komisionesh që kanë dalë në terren për të bërë verifikimin e dëmeve. Mund të shikosh edhe emrat se kush janë të komisionit dhe urdhërin e brendshëm.

Bashkim Hoxha(këshilltar): Të vijë një përfaqësues I këtyre komisioneve të dali me hartë se ku ka shkuar. Janë mbytur gjëja e gjallë ,kosheret e bletëve,ju këto nuk I quani.

Albiona Mehmeti(këshilltar): Këto nuk përfshihen tek kjo pikë, sepse është vetëm për pajisje, mobilje, orendi elektroshtëpiake. Procesverbal i detajuar me firmat e anëtarëve të komisionit, firmat e familjarit për të cilën ato kanë qenë prezent, e dokumentuar me foto. E dokumentuar me foto dhe me video dhe ndërkohë që Bashkia e Shijakut ka qenë e hapur 24 orë për të pritur ankesat e çdokujt.

Elson Kastrati(këshilltar): Albiona a janë mbyllur afatet ?

Albiona Mehmeti: Lista pësoj ndryshime nga dje deri sot, sepse kërkesa kishte edhe sot, ndoshta kërkesa mund të ketë edhe nesër. Nëse do ketë kërkesa të tjera, ne i administrojmë, i vlerësojmë dhe i risjellim sërish në këshill dhe bëjmë një ndryshim të vendimit që është.

Marilda Tusha(këshilltar): Këtu keni familjarë nga e njëjta familje,ndërkohë që fisi tjetër që është mbytur ne ujë nuk janë fare në këtë listë. Bëhet fjalë për te familja Rexhepi. Ka familje që nuk e kanë marrë vesh Akoma që do të ketë vlerësim.

Albiona Mehmeti: Në faqen zyrtare të bashkisë kanë qenë të publikuara dhe janë të publikuara. numrat e telefonit dhe personat përgjegjës, të cilët përgjigjeshin në kohë reale

Bashkim Hoxha(këshilltar): Është qesharake dëmshpërblimi që keni vënë. Minimumi I dëmit për një shtëpi është 10 mijë euro.

Shpresa Domi: Puna vazhdon Akoma, grupet e punës do të dalin përsëri në terren.

Bashkim Hoxha(këshilltar): Në qoftë se vazhdon, se këto lista do ti vendos në afishe. Kush është komisioni që do ti kontaktojë. Ju thoni që bagëtitë e koshered e bletëve nuk kompensohen. Çfarë kompensimi është ky.

Lumturije Keci(këshilltar): Për gjënë e gjallë duhet të aplikohet tek Ministria e Bujqësisë.

Sulejman Tola: Po shteti do ti paguajë o Bashkim. Albiona përse është bërë me urgjencë kjo mbledhje ? Afat kohor a ka për emra të tjetër ? Na jipni fjalën nëse do të kete të tjeë do të na I sillni ti kalojmë.

Albiona Mehmeti: Ky proces po zhvillohet me urgjencë, sepse është e domosdoshme që listat të dërgohen sa më shpejt, të përthithen sa më shumë grante dhe të shpërndahen menjëherë.

Nëse miratimi bëhet sot, lista do të dërgohet menjëherë në prefekturë për zbatim. Nëse nuk miratohet sot, procesi shtyhet deri në miratimin e radhës.

Ndërkohë, grupi përgjegjës vazhdon të ndjekë kërkesat e tjera që paraqiten. Këto kërkesa shqyrtohen për të parë nëse plotësojnë të njëjtat kushte, dhe nëse po, sjellen sërish për miratim.

Tauland Xheraj (Sekretar I Përgjithshëm): Bashkimi po flet në ajër pasi nuk ka emra konkretë.

Arlind Bici (këshilltar): Nëse gjëja e gjallë nuk përfshihet në këtë vendim atëherë ta kalojmë.

Elson Kastrati (këshilltar): E mira është ta shtyjmë 1 javë këtë vendim.

Mimoza Xhiani (këshilltar): Nxirri emra konkretë, të shkojë komisioni të verifikojë dhe ti shtojmë, pse ti djegim të tjerët.

Marilda Tusha (këshilltar): Shumica nuk e kanë marrë vesh, unë nuk e dija për vete këtë proces, mendoj ti bëjmë të gjithë bashkë ti fusim dhe ata që kanë nevojë.

Vjola Cyrbja (këshilltar): Të shkonin në bashki, përse nuk kanë shkuar, lajmërimi ka dalë në rrjete sociale dhe në Tv.

Sulejman Tola: Nëse ska pyetje të tjera e kalojmë në votim.

Kozeta Doda (Sekretare e Këshillit Bashkiak): Hapim procesin e votimit për vetme të rendit të ditës:

Pro: 16



Kunder: -

Anstenim: -

Miratohet

Sulejman Tola: Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrjen!

Mbajtësi I Protokollit:
Kozeta Doda

KRYETARLI KESHILLIT
Sulejman Tola


ARLIND BICI

LUNDURUJE KEQA
